

## SYLË UKSHINI

### ROLI I POLITIKËS GJERMANE NË KONFERENCËN E PAQES NË RAMBUJE

#### Hyrje

Kështjella franceze e qytetit të vogël francez Rambuje (Rambouillet) afër Parisit ishte vendi ku u zhvillua Konferenca e Parë Ndërkombëtare për Kosovën. Më 6 shkurt 1999 shqiptarët e Kosovës dhe delegacionit serb nën mbikëqyrjen e vendeve anëtare të Grupit të Kontaktit (GK) zhvilluan negociatën për arritjen e një zgjidhje kalimtare për statusin e Kosovës. Mbi të dyja palët ndërmjetësit ndërkombëtarë dhe vendet e GK, në këtë mes edhe Gjermania, ushtruan trysni mbi palët për arritjen e një marrëveshjeje paqësore kalimtare. Mirëpo, kjo konferencë ndërkombëtare, megjithëse marrëveshja u nënshkrua nga pala shqiptare, dështoi për shkak të qëndrimit refuzues të Beogradit dhe kursit konfrontues të Milosheviçit me Perëndimin.

Ky punim analizon qëndrimin dhe rolin e politikës gjermane në raport me luftën e Kosovës, me theks të veçantë gjatë periudhës së negociatave shqiptaro-serbe në Konferencën e Rambujesë, jo vetëm nga perspektiva e politikës nacionale gjermane, por edhe këndvështrimi multilaterizmit në periudhën e presidencës gjermane të Bashkimit Europian (BE). Duke pasur parasysh se politika e jashtme gjermane që nga paslufta e Dytë Botërore është zhvilluar nën maksimën e multilaterizmit, është me rëndësi dimensionin në kontekstin e BE-së dhe institucionet e tjera ndërkombëtare. Si në politikën e jashtme të çdo vendi, edhe në politikën e jashtme gjermane, ndikoi jo vetëm ambienti i brendshëm kombëtar, por edhe ai ndërkombëtar, veçanërisht vendimet e organizatave ndërkombëtare, para së gjithash i atyre organizatave ku Gjermania është anëtare aktive. Prandaj, Gjermania edhe në Konferencën e Rambujesë ishte e detyruar të bashkëpunonte gjatë vendimmarrjes me organizatat në të cilat ajo ishte anëtare. Këto rrethana ishin përcaktuese për kornizat e politikës së jashtme gjermane ndaj Kosovës dhe se ajo nuk mund të vepronte jashtë këtij ambienti ndërkombëtar. Gjithashtu është prezente edhe tendeca franko-britanike për ta anashkaluar rolin e politikës gjermane, madje fillimisht ekzistonte ideja e mospërfshirjes fare

të shtetit gjerman. Ky format i bisedimeve, pjesëmarrja vetëm e Britanisë së Madhe, Francës, SHBA-së dhe Ruisë, sipas kryesuesit britanik, bëhej me intencën për të pasur negociata sa më efektive dhe për të qenë në gjendje për të ushtruar trysni maksimale ndaj palëve në konflikt. Ky propozim në takimin e GK, në Bon u kundërshtua me vendosmëri nga pala gjermane. Aq më tepër që asokohe shteti gjerman mbante presidencën e radhës së BE-së dhe kryesonte Grupin G8. Për më tepër, ndaj koalicionit të ri qeveritar gjerman kuq-gjelbër reflektohej një mosbesim mbi të gjitha në Paris dhe në Londër. Ky ishte koalicioni i parë i së majtës në historinë e Republikës Federative të Gjermanisë. Tek vendet fqinje kishte dilema dhe mosbesim për kahet e politikës së jashtme gjermane.

#### **Nisma dhe formati i Konferencës së Rambujesë**

Masakra e Reçakut, 15 janar 1999, ishte ngjarja kryesore që determinoi veprimin e diplomacisë ndërkombëtare, e cila e kishte të qartë se Milosheviçi nuk po e respektonte më marrëveshjen e tij të arritur me Hollbrukun pak muaj më parë. Por, derisa në disa vende evropiane ende kishte hezitim për mënyrën e kundërpërgjigjes ndaj Beogradit, SHBA, ndërmjet datave 18 dhe 25 janar të vitit 1999, shtroi në Këshillin e Aleancës Ushtarake Veriatlantike (NATO) çështjen e dërgimit të trupave tokësore. Te vendet evropiane shtrohej pyetja nëse një reagim ushtarak i NATO-s do të kishte reaksione negative në publikun e brendshëm, apo jo. Në këtë kontekst, vetëm Britania e Madhe ishte përkrah qëndrimit amerikan për përdorimin e forcës ushtarake kundër Milosheviçit. Në këtë sfond të zhvillimeve fitoi terren ideja e evropianëve për thirrjen e një lloj konference sipas shembullit të Dejtonit, “mini-Dayton”.<sup>1</sup> Edhe pse ideja fillestare për Konferencën e Rambujesë rrodhi nga Ministria e Jashtme e Gjermanisë, Joschka Fischer, asokohe ministër i Jashtëm i Gjermanisë, në librin e tij të fundit “*Vitet kuq-gjelbër, politika e jashtme gjermane nga Kosova e deri më 11 shtator*”, rolin për organizimin e Rambujesë ia atribuon Francës dhe Britanisë së Madhe, madje, sipas tij, Robin Kuk

<sup>1</sup> Në periudhën dhjetor 1998 – janar 1999, kur u bë e qartë se konflikti i Kosovës po merrte përmasa të reja, në Bon u mendua për një qasje të re intensive. Në një shënim për kancelarin federal të Gjermanisë, këshilltari i tij për politikën e jashtme, Mihajl Shtajner, për herë të parë përmendi “një lloj Konference mini-Dejton”. Për më shumë shih: *Günter Jozter, Der letzte Krieg in Europa? Das Kosovo und die deutsche Politik*, Stuttgart: 2001.

kishte propozuar që në konferencë të merrin pjesë vetëm Franca, Britania e Madhe, SHBA-ja dhe Rusia.<sup>2</sup> Më në fund në takimin e ministrave të Jashtëm të GK, në Londër, më 29 janar 1999, u vendos të thirreshin në mënyrë ultimative përfaqësuesit e shqiptarëve të Kosovës dhe ata të Jugosllavisë së mbetur, për të zhvilluar bisedimet me dyer të mbyllura në kështjellën franceze të Rambujesë, më 6 shkurt 1999.

Por, takimi i Londrës evidentoi edhe një mosunitet dhe tendencë për mënjanimin e rolit gjerman, që nganjëherë shihet edhe si një mosvlerësim tradicional ndaj diplomacisë gjermane, nga francezët dhe britanikët.<sup>3</sup> Formula e pjesëmarrjes justifikohet me argumentin se në Konferencë duhet të ishin pjesëmarrëse vetëm anëtarët e përhershëm të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, gjë e cila nuk kishte ndodhur në Dejton. Veç kësaj, veçanërisht francezët dhe britanikët dëshironin që kjo konferencë të mbahej në Evropë dhe jo në SHBA. Por, vendosmëria e ministrit të Jashtëm gjerman, J. Fischer, në takimin e GK, bëri që propozimi i ministrit të Jashtëm britanik Robin Cook, që në këtë konferencë, krahas shteteve kryesuese, Francës dhe Britanisë, të merrnin pjesë edhe SHBA-ja dhe Rusia, të mos kalonte. Fischer dhe bashkëpunëtorët e tij nuk e lejuan këtë rol dytësor të Gjermanisë dhe kërkuan me këmbëngulje korrigjimin e kësaj qasjeje, e cila u konsiderua “kontraproduktive dhe e papranueshme”.<sup>4</sup> Krahas kësaj, sipas këndvështrimit të palës gjermane, po të mbahej Gjermania jashtë konferencës, do t’i dërgohej një sinjal i gabuar Beogradit dhe Moskës se në radhët e GK ekziston përçarje dhe krahas kësaj, një formulë e tillë e pjesëmarrjes selektive, e propozuar nga kryesuesi i takimit të GK, nuk ishte një ide e mirë në kuadër të përpjekjeve për të siguruar një strategji të sukseshme të negociatave për zgjidhjen politike të problemit të Kosovës.<sup>5</sup>

Veç tjerash, këtë hezitim të britanikëve dhe francezëve, publicisti dhe eksperti gjerman për Ballkanin, Erich Rathfelder e shpjegon si mosbesim ndaj qeverisë së re të kolacionit kuq-gjelbër nën drejtimin e Gerhard Shrederit dhe Joscha Fischer. Ai konkludon se tre aleatët e

<sup>2</sup> Joschka Fischer, *Die rot-grünen Jahre. Deutsche Außenpolitik – vom Kosovo bis zum 11. September*, Köln: 2007, f. 129.

<sup>3</sup> Joachim Krause, "Deutschland und die Kosovo-Krise", në Jens Reuter & Conrad Clewing (Hrsg.), *Der Kosovo-Konflikt. Ursachen, Verlauf, Perspektiven*, Klagenfurt: Wieser Verlag, 2000, f. 409-410.

<sup>4</sup> J. Fischer, *Die rot-grünen Jahre ...*, f.130-131.

<sup>5</sup> *Po aty*, f.128-129.

Luftës së Dytë Botërore, SHBA, Britania e Madhe dhe Franca, dëshironin vetë t'i bënin gjërat.<sup>6</sup> Ai po ashtu në këtë qëndrim shihte edhe shkakun e qëndrimit hezitues që kishte pasur qeveria gjermane e Helmut Kohl. Eksperti i Ballkanit dhe ish-përfaqësues i Lartë në Bosnjë dhe Hercegovinë, Christian Schwarz-Schilling, kishte deklaruar se ky qëndrim i Kohlit rridhte nga përvoja e Luftës së Dytë. Konsekuenca që Gjermania “kurrë më” (*nie wieder*) të mos përfshihet në një luftë, për Kohlin kishte qenë pjesë e indetitetit politik, për shkak se ai qysh në luftën e Bosnjës kishte operuar me shumë kujdes, ndërsa lidhur me Kosovën, ai nuk dëshironte të ndërmerre ndonjë iniciativë. Prandaj, aleatët perëndimorë, siç duket, mendonin se me qeverinë e re të koalicionit kuq-gjelbër ky qëndrim hezitues i Gjermanisë vetëm sa ishte konsoliduar.<sup>7</sup>

Po ashtu, është e qartë se qëndrimi i gjermanëve shpesh në një lloj pozicioni ngurrues ose në radhën e dytë, ishte edhe si pasojë e vetë-përmbajtjes tradicionale gjermane, e cila vinte sa për shkak të hipotezës së Luftës së Dytë Botërore, aq edhe për shkak të frikës së një konfrontimi me Parisin dhe Londrën, ashtu siç kishte ndodhur në fillim të procesit të shpërbërjes së Jugosllavisë në fillim të viteve 90-të. Madje, vetë J. Fischer bën të ditur se ai e kishte kundërshtuar idenë e bashkëpunëtorëve të tij të ngushtë që Gjermania të organizonte Konferencën për Kosovën, pasi, sipas tij, gjermanët nuk ishin në gjendje ta bënin këtë gjë.<sup>8</sup> Po ashtu, është e dukshme se gjermanët edhe atëherë kur ishin aktivë dhe mbështetës të linjës dhe qëndrimit amerikan, dëshironin që të mos shkaktonte irritim dhe për këtë parapëlqenin të vepronin nga prapavija. Megjithëse Boni favorizonte një zgjidhje politike në rrafshin shumëpalësh, që ishte edhe lajtmotiv strategjik i politikës së jashtme gjermane, për gjermanët si vend anëtar i NATO-s, ishte i pritshëm intervenimi i NATO-s për shkak të diskursit konfrontues të Beogradit. Ndaj ushtria gjermane duhej të merrte përsipër rrezikun e plotë ushtarak,

<sup>6</sup> Eksperti gjerman për Ballkanin, Erich Rathfelder, rrëfen se në fillim të bisedimeve gazetari i gazetës “*Sunday Times*”, Tom Walker e kishte ftuar në një konferencë shtypi në afërsi të Kështjellës së Rambujesë të thirrur nga Ministria e Jashtme e Britanisë së Madhe. Por, aty ishin lejuar të merrnin pjesë vetëm gazetarët britanikë, amerikanë dhe francezë. Kështu zyrtari britanik i shtypit i kishte kërkuar ekspertit gjerman që të largohej nga konferenca për shtyp. Erich Rathfelder, *Kosovo - Geschichte eines Konflikts*. Suhrkamp Verlag, Berlin: 2010, f.228.

<sup>7</sup> Po aty, f.228.

<sup>8</sup> J. Fischer, *Die rot-grünen Jahre ...*, f.128; Roland Friedrich, *Die deutsche Außenpolitik im Kosovo-Konflikt*, Wiesbaden: 2005, f.71.

ndërsa qeveria federale gjermane do të barte rrezikun e plotë politik. Megjithatë, ishte e dukshme që nga fillimi se gjermanët nuk dëshironin protagonizëm në këtë konferencë, edhe pse ideja fillestare për një Dejton erdhi pikërisht nga Boni, nga Ministria e Jashtme e Gjermanisë.<sup>9</sup>

Por, gjatë rrjedhës së përgatitjeve të konferencës, ministri i Jashtëm gjerman Fischer, pas shumë insistimesh dhe këmbënguljeve, ia doli që të forconte kohezionin e shteteve evropiane, pasi në emër të BE-së, në bisedimet e Rambujesë do të merrte pjesë i dërguari i saj Wolfgang Petritsch, i cili kishte mandat dhe përgjegjësi për t'i raportuar Presidencës së BE-së dhe në këtë mënyrë ai ishte i detyruar të bashkëpunonte ngushtë me palën gjermane si dhe të përfaqësonte në një masë të madhe pozicionin e politikës gjermane.<sup>10</sup>

Si rrjedhim i kësaj, në fund të takimit me GK në Londër u vendos që Konferenca e Rambujesë do të kryesohej nga ministrat e Jashtëm të Francës dhe Britanisë, Hubert Vedrin dhe Rubin Kuk, ndërsa si kryesues të bisedimeve u emëruan diplomatët Chris Hill për SHBA-në, Wolfgang Petritsch për BE-në dhe Boris Majorski për Federatën Ruse.<sup>11</sup> Ata mbështeteshin edhe nga grupe të ndryshme ekspertësh të vendeve të GK, OSBE-së dhe BE-së, si dhe institucionet e tjera ndërkombëtare.<sup>12</sup> Në fund të takimit, vendet anëtare u dakorduan që Britania e Madhe t'i njoftonte palët në konflikt me parimet e kornizat kohore, formatin e Konferencës, formulën e pjesëmarrjes dhe definimin e synimeve që duhej arritur, si dhe t'i ftonte ato për pjesëmarrjen në Konferencën e Rambujesë.

Menjëherë pas takimit të ministrave të Jashtëm të GK-së në Londër, ministri i Jashtëm britanik, Robin Cook, udhëtoi në rajon dhe zhvilloi

<sup>9</sup> Kështu kishte deklaruar më 15 nëntor 1999, Ludger Vollmer, atëherë Sekretar Shteti në Ministrinë e Jashtme në Bon, në një bisedë me Karsten Triuphaus, autor i studimit *Institutionalisierung und Konfliktprävention, Die deutsche KSZE/OSZE-Politik in den neuziger Jahren*, Universität Trier: 2001. Ndërkaq, gazetari gjerman Gynter Hofman, i cili ka konsultuar aktet e Ministrisë së Jashtme në Bon, në maj të vitit 1999, në javoren "Die Zeit", shkruan se britanikët dhe anglezët ishin marrë vesh që, krahas ndërmjetësve të Grupit të Kontaktit, Ruisë dhe BE-së, në koonferencë të merrnin pjesë vetëm ata. Günter Hofmann, "Wie Deutschland in den Krieg geriet", "Die Zeit", 12.05.2005.

<sup>10</sup> R. Friedrich, *Die deutsche aussenpolitik im Kosovo-konflikt ...*, f.71.

<sup>11</sup> Wolfgang Petritsch, Karl Kaser, Robert Pichler, *Kosovo/Kosova. Mythen, Daten, Fakten, Kosovo Kosova. Mythen*, Klagenfurt-Celovec/Wien/Ljubljana/Tuzla/Sarajevo: 1999, f.268.

<sup>12</sup> Marc Weller, "The Rambouillet Conference on Kosovo", në *International Affairs*, 75 (1999) 2, f.227.

takime me palën shqiptare të Kosovës dhe autoritetet serbe, për të diskutuar parimet e planit të paqes. Grupi i Kontaktit ishte deklaruar se është i vendosur që t'i detyrojnë palët që të ulen në tavolinën e bisedimeve në Rambuje dhe që të arrijë një zgjidhje politike kalimtare për statusin e Kosovës. Një qëndrim të këtillë e kishte ripërsëritur edhe kancelari gjerman, Gerhard Schröder, gjatë një takimi me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Javier Solana, më 1 shkurt 1999. Ai kishte paralajmëruar se bashkësia ndërkombëtare e kishte seriozisht, kur kërcënonte me sanksione palët në konflikt. M. Weller, negociatat e Rambujesë i karakterizoi si “negociata të imponuara”. Shqiptarëve të Kosovës iu bë presion me kërcënimin politik, se në qoftë se nuk pranojnë negociatat, anëtarët e NATO-s, duke përfshirë SHBA-në, do të tërhiqeshin nga zgjidhja e çështjes së Kosovës, ndërsa serbët ishin të detyruar për të negociuar me kërcënimin e forcës ushtarake të NATO-s. Negociatat nxorën në sipërfaqe dallimet mes diplomatëve amerikanë dhe evropianë. Në këtë kontekst, Schröder konfirmonte gjithashtu se Gjermania pa asnjë hezitim mbështet qëndrimin e GK lidhur me pritjet e Konferencës së Rambujesë për zgjidhjen paqësore të çështjes së Kosovës. Ky pozicion duket qartë edhe nga pohimi i ministrit të Jashtëm gjerman, i cili në mënyrë të vendosur deklaronte se nuk ka hapësirë manovrimi për taktika bllokuese nga palët pjesëmarrëse në konferencë.<sup>13</sup>

Që në bisedimet e para përgatitore, GK paraqiti katalogun e parimeve panegociueshme (*Contact Group Negotiable Principles / Basic Elements*)<sup>14</sup> për bisedimet midis palëve. Këto parime ishin bazë për negociatat paqësore dhe që në fillim u ishte bërë e qartë palëve të armiqësuar se 80 % e planit të paqes ishte i padiskutueshëm dhe se duhej të nënshkruhej pa ndryshime. Thjesht vetëm 20 % e dokumentit mund të ndryshohej.<sup>15</sup> Me një fjalë, negociatat në Rambuje ishin të imponuara.

<sup>13</sup> Sylë Ukshini, *Kosova dhe Perëndimi*, Prishtinë: Rilindja, 2001, f.174-175.

<sup>14</sup> Elementët bazë të këtij plani ishin hartuar nga ambasadori Petritsch, të cilat në thelb përbënin formulimet e Marrëveshjes Holbrooke – Milosheviç dhe qëndrimet e Grupit të Kontaktit u bënë bazë e panegociueshme (*Non-Negotiable Principles*) për bisedimet e Rambujesë. Wolfgang Petritsch, Karl Kaser, Robert Pichler (Hrsg.): *Kosovo/Kosova, Mythen, Daten, Fakten ...*, f.264-267.

<sup>15</sup> "Vorläufiges Abkommen für Frieden und Selbstverwaltung im Kosovo, Rambouillet, 23 Februar 1999 (Auszüge)", në *Blätter für deutsche und internationale Politik*, 44 (1999) 5, f. 611-629.

Duke analizuar me kujdes këto qëndrime dhe pozicionin e shtetit gjerman, duket qartë se pala shqiptare dhe ajo serbe nuk kishin alternativë, pos të uleshin në tavolinën e bisedimeve në Rambuje dhe brenda një periudhe dyjavore të arrinin një zgjidhje kalimtare për çështjen e statusit politik të Kosovës. Në të kundërtën, për shqiptarët e Kosovës, objektivi themelor i të cilëve ishte ndërkombëtarizimi i krizës, tërheqja e mbështetjes ndërkombëtare do të çonte sigurisht në disfatë. Ndaj, qëndrimi i Gjermanisë dhe i vendeve të tjera të GK ishte se Konferenca e Rambujesë përbënte një shans të madh për bërjen e paqes, të cilin palët në konflikt nuk do të duhej ta humbisnin. Në këtë rrethanë, tre ditë para skadimit të ultimatumit të GK, të dyja palët në Prishtinë<sup>16</sup> dhe në Beograd u deklaruan të gatshme për të marrë pjesë në bisedimet e Konferencës së Paqes në Rambuje të Francës. Ishte pozitive për procesin politik që edhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës (UÇK) i thoshte "po" pjesëmarrjes në Konferencën e Rambujesë. Ky veprim i saj përbënte një strategji politike dhe sjellje pragmatike, pasi në këtë mënyrë ajo legjitimohej ndërkombëtarisht si faktor kyç pa të cilin nuk mund të zgjidhej çështja e Kosovës.

Krahas bërjes publike të parimeve orientuese të bashkësisë ndërkombëtare për zgjidhjen e çështjes së Kosovës, edhe pse zyrtarisht nuk përmendej pjesëmarrja e NATO-s, sipas gazetës gjermane "*Berliner Zeitung*", ushtarakët e NATO-s kishin filluar të përgatishnin planet për stacionimin e 30 mijë trupave ushtarake të Aleancës në Kosovë për garantimin dhe implementimin e Marrëveshjes së Paqes. Në këtë kuadër, qeveria gjermane kishte shprehur gatishmërinë për dërgimin e 3000 ushtarëve të *Bundeswehr*-it (*Armata Gjermane*). Po kështu, rreth stacionimit të ushtarëve gjermanë në Kosovë, në Bon pati shumë debate për koston e lartë financiare që duhej të merrte përsipër shteti gjerman, duke pasur parasysh edhe 400 milionë marka që shpenzoheshin për misionin paqeruajtës në Bosnjë dhe Hercegovinë.<sup>17</sup> Në fakt, shteti gjerman që nga fillimi i viteve '90-të, madje më herët se shtetet e tjera,

<sup>16</sup> Përfaqësuesi i BE-së për Kosovën në Konferencën e Rambujesë, ambasadori austriak Wolfgang Petritsch, në librin "Kosova" thekson se, përderisa Adem Demaçi, përfaqësues politik i UÇK-së, refuzoi pjesëmarrjen në konferencë, Hashim Thaçi, drejtor politik i UÇK-së, më 3 shkurt 1999 i konfirmoi Petritsch gatishmërinë e tij për pjesëmarrjen në Konferencën e Rambujesë. W.Petritsch, K.Kaser, R.Pichler, *Kosovo – Kosova ...*, f.275.

<sup>17</sup> S. Ukshini, *Kosova dhe Perëndimi ...*, f. 176-177.

njohu natyrën potencialisht eksplozive të problemit të Kosovës dhe që në vitin 1992 përkrahu dërgimin e vëzhguesve të OSBE-së dhe më pas do të përfshihej në marrjen e vendimit të mundshëm për luftë dhe për paqebërje në kuadër të misionit të KFOR-it. Në përgjithësi, Bundeswehri me angazhimin e tij në rastin e Kosovës për përballimin e detyrimeve të NATO-s po dëshmohej si një partner i besueshëm dhe në nivel të njëjtë përgjegjësie me partnerët e tjerë evropianë.

### **Karakteri i negociatave të Rambujesë**

Më 6 shkurt 1999, në kështjellën e Rambujesë afër Parisit, filluan bisedimet shqiptaro-serbe për gjetjen e një zgjidhjeje kalimtare për çështjen e statusit politik të Kosovës.<sup>18</sup> Në rrafshin ndërkombëtar kjo konferencë ishte iniciativa e fundit dhe më e rëndësishme ndërkombëtare për paqe, e cila u zhvillua katër vjet pas Dejtonit dhe afro një dekadë pas konferencave të Hagës (1991) dhe Londrës (1992), në të cilat çështja e Kosovës ishte trajtuar në mënyrë periferike ose ishte anashkaluar fare. Etapa e parë e bisedimeve u zhvillua në harkun kohor nga 6 deri më 23 shkurt. Ndërsa etapa e dytë, vazhdoi nga 15 deri më 18 mars në qendrën e konferencave në Kléber të Parisit.<sup>19</sup>

Kur delegacionet e Kosovës dhe Serbisë arritën në Rambuje, të gjithëve u ishte bërë e qartë se kjo mund të ishte mundësia e fundit për të arritur një zgjidhje politike, përveç palës serbe, e cila dërgoi një delegacion të parëndësishëm. Milosheviçi nuk ishte i pranishëm dhe në këtë mënyrë u zbehën shanset për kompromis. Për dallim nga serbët, delegacioni i shqiptarëve të Kosovës përbëhej nga përfaqësues të partive kryesore kosovare.<sup>20</sup> Delegacioni drejtohej nga një kryesi e përbërë nga Rugova, Qosja, Thaçi dhe Surroi. Ndërsa, kryesuesi i delegacionit të Kosovës u zgjodh Hashim Thaçi, udhëheqësi i Drejtorisë Politike të

<sup>18</sup> Një prezantim gjithëpërfshirës të historisë së dy konferencave të Rambujesë dhe Parisit e ofron M. Weller në artikullin e tij "The Rambouillet conference on Kosovo ...", f. 211- 252.

<sup>19</sup> *Po aty*.

<sup>20</sup> Delegacioni i shqiptarëve të Kosovës në Konferencën e Rambujesë përbëhej nga: Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Edita Tahiri, Bujar Bukoshi dhe Idriz Ajeti (Lidhja Demokratike e Kosovës); Rexhep Qosja, Hydajet Hyseni, Mehmet Hajrizi dhe Bajram Kosumi (Lëvizja e Bashkuar Demokratike); Hashim Thaçi, Jakup Krasniqi, Azem Sylja, Ramë Buja dhe Xhavit Haliti (përfaqësues të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), si dhe dy publicistët e pavarur: Veton Surroi (editor i gazetës *Koha Ditore*) dhe Blerim Shala (editori i gazetës *Zëri*).

UÇK-së,<sup>21</sup> dhe pas kësaj ai shumë shpejt u bë figura kyçe në radhët e delegacionit të shqiptarëve të Kosovës.<sup>22</sup> Sipas Antje Volmer, politikane gjermane nga radhët e të Gjelbërve, ky veprim injorues i negociatorëve perëndimorë karshi Rugovës dhe vlerësimi i tyre në Rambuje, ka qenë i ngutshëm. Sipas tij, “e gjithë kjo Rugovës mund t’i jetë dukur një lojë me mashtrime, gjë që pjesërisht shpjegon heshtjen e tij.”<sup>23</sup> Ndërkaq, përfaqësuesi i rëndësishëm politik i UÇK-së, Adem Demaçi, i njohur si Nelson Mandela shqiptar, sepse në ish-Jugosllavi kreu plot 28 vjet burg, refuzoi pjesëmarrjen në konferencë dhe krejt parimet bazë të kësaj konference. Ai kërkonte që çështja e pavarësisë të shtrohej në bisedime, pasi kishte frikë se pranimi i marrëveshjes edhe nga Beogradi, çështja e Kosovës do të mund të kalonte në periferi dhe me kalimin e viteve nuk do të mund të rikthehej në axhendë ndërkombëtare opsioni i pavarësisë. Për shkak të këtij pozicioni të kundërt me delegacionin e Kosovës dhe të ndërmjetësve ndërkombëtarë, pak kohë pas Konferencës së Rambujesë ai humbi postin e tij brenda UÇK-së.<sup>24</sup> Një ditë para fillimit të Konferencës tre ndërmjetësuesit kryesorë të konferencës, Petritsch, Hill dhe Majorski, ishin takuar në selinë e ambasadës amerikane në Paris për të diskutuar mbi përcaktimin e një strategjie përfundimtare lidhur me hapat e veçantë gjatë procesit të bisedimeve. Ndërmjetësit e kishin të qartë se pa pjesëmarrjen e UÇK-së nuk mund të gjendej asnjë zgjidhje për çështjen e Kosovës.

Nisja e punës së Konferencës së Rambujesë u shoqërua me një lloj ceremonie nga presidenti i Francës, Jacques Chirac dhe dy bashkë-kryesuesit e konferencës, ministrat e Jashtëm britanik dhe francez, Robin Cook dhe Hubert Vedrin. Si presidenti francez, Chirac, ashtu edhe dy

<sup>21</sup> K.Kaser, W.Petritsch, Pichler, *Kosovo – Kosova ...*, f. 280; *Fjalori Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2008, f.1248.

Në mendimin e sekretares amerikane të Shtetit caktimi i Thaçit pasqyrore rënien e vazhdueshme të pozicionit të Rugovës, i cili pas gjithë asaj fyerjeje nuk e hapi gojën thujse fare. Kur njëri nga diplomatët tanë, kujton ajo, e pyeti Rugovën pse ishte aq i plogësht, ai u përgjigj: “Ky është stili im”. Madeleine Albright, *Madame Secretary*. München: C. Bertelsmann, 2003, f. 466.

<sup>22</sup> J. Fischer, *Die rot-grünen Jahre ...*, f.134.

<sup>23</sup> *Veç pavarësi, asgjë më pak - Ibrahim Rugova në shtypin gjermanofon (1989-2006)*, përzgjedhur dhe përkthyer nga Enver Robelli, Prishtinë: Koha, 2015, f.112-113.

<sup>24</sup> Jens Reuter, "Die Kosovo-Politik der internationalen Gemeinschaft in den neunziger Jahren", në: Konrad Clewing, Jens Reuter (Hg.), *Der Kosovo-Konflikt. Ursachen, Verlauf und Perspektiven ...*, f. 327.

bashkëkryetarët e konferencës, Vedrin dhe Cook, në fjalën e hapjes u bënë thirrje palëve në konflikt që të ulëshin në tryezën e bisedimeve për t'u marrë vesh me njëri-tjetrin. Në fjalën e tij, Presidenti francez vlerësoi se kjo konferencë ishte një moment historik për bërjen e paqes në Kosovë, duke sjellë si krahasim armiqësitë historike franko-gjermane, e cila për një kohë të gjatë cilësohej si e pakapërcyeshme, por së fundi u kapërcye kur gjenerali De Gaulle dhe kancelari gjerman Adenauer vendosën të ndërtonin një të ardhme të përbashkët. Në këtë pikëvështrim, Presidenti francez nënvizonte se edhe kësaj radhe është në duart e njerëzve të rëndësishëm të Kosovës dhe Serbisë që të vendosin për paqen dhe për mirëkuptimin kundër urrejtjes dhe luftës në Kosovë.<sup>25</sup>

Megjithëse, parimet orientuese të negociatave ishin të pandryshueshme dhe rolin prijës në këtë konferencë e kishin kryesisht dy vendet evropiane të Grupit të Kontaktit, Franca dhe Anglia, gjatë rrjedhës së konferencës deri diku e mori edhe Gjermania, e cila në procesin negociues përfaqësohej përmes diplomatit të Ministrisë së Jashtme gjermane, Axel Ditman,<sup>26</sup> i cili ishte pjesë e grupit të përfaqësuesit të BE-së, Wolfgang Petritsch.

Në fakt negociatat e Rambujesë drejtoheshin nga tre kryesuesit e negociatave nga SHBA-ja, BE-ja dhe Rusia, Petritsch, Hill dhe Majorski, ndërsa delegacionet e shteteve të tjera anëtare të GK operonin nga prapaskena ose si vëzhgues.<sup>27</sup> Kjo skenë natyrisht reflektonte rivalitetin dhe garën ndërmjet shteteve evropiane për prestigj ndërkombëtar dhe dëshirën për të luajtur rol udhëheqës në Konferencën e Rambujesë, e cila, në rast se do të rezultonte me sukses, do të hynte në histori dhe ky sukses do t'i detyrohej shteteve drejtuese.

Duke pasur parasysh mungesën e eksperiencës së palës shqiptare në konferenca dhe forume ndërkombëtare, dy ekspertë të shquar të së drejtës ndërkombëtare amerikani Morton Abramowitz, ish-kryetar i Grupit Ndërkombëtar të Krizave, si dhe Paul Williams dhe Marc Weller, i

<sup>25</sup> Fjala e presidentit të Francës është cituar sipas: Robert Pichler, *Die Politik der Internationale Gemeinschaft in der Kosova Frage (1992-1999)*, (Diss.) Karl-Franzens - Universität Graz: 2002, f. 169; "Chirac beschwört in Rambouillet den historischen Augenblick", në *FAZ*, 8.2.1999; Christian Lequesne, "Die Außenpolitik von Jacques Chirac oder: Frankreich ohne Überraschungen", në *Forschungsinstitut der Deutschen Gesellschaft für Auswärtige Politik (DGA)*, Berlin: Oktober 2007, no. 2, f.7.

<sup>26</sup> W. Petritsch, K. Kaser, R. Pichler, *Kosovo – Kosovo ...*, f.269.

<sup>27</sup> J. Fischer, *Die rot-grünen Jahre ...*, f.134.

ofruan ekspertizë profesionale juridike-politike delegacionit të Kosovës.<sup>28</sup>

Cilat ishin shanset e Konferencës për arritjen e paqes në Kosovë? *E para*, përbërja e delegacioneve qysh në hapjen e konferencës sinjalizonte se kishte pak gjasa për një konferencë të suksesshme. Mospjesëmarrja e Milosheviçit në bisedime dhe vazhdimi i fushatës ushtarake në Kosovë tregonte se Beogradi nuk ishte i interesuar për zgjidhje politike dhe as i gatshëm për asnjë lloj autonomie për Kosovën. *E dyta*, megjithëse Konferenca e Rambujesë konceptualisht ishte e orientuar në modelin e bisedimeve të Dejtonit, e cila pati sukses kishte dallime të mëdha, të cilat përcaktuan edhe rrjedhën e bisedimeve. Derisa Konferenca e Dejtonit ndodhi kur palët pjesëmarrëse ndiheshin të lodhura nga lufta pesëvjeçare dhe për më tepër në Bosnjë dhe Hercegovinë më 1995 kroatët dhe boshnjakët, të trajnuar dhe të armatosur nga SHBA, u kishin shkaktuar humbje serbëve dhe paralelisht me këtë NATO kishte goditur caqet ushtarake të serbëve, përkundrazi në prag të Konferencës së Rambujesë gjendja në Kosovë po shkonte drejt përshkallëzimit të mëtutjeshëm, meqë serbët kishin epërsi ushtarake ndaj UÇK-së<sup>29</sup> dhe me Marrëveshjen e 13 tetorit 1998 i ishin shmangur goditjeve ushtarake të NATO-s. Sidoqoftë, për bashkësinë ndërkombëtare derisa lufta në Bosnjë e Hercegovinë mund të mbahej e lokalizuar, në rastin e Kosovës ekzistonte rreziku i shtrirjes së luftës në rajon, duke filluar në Maqedoni e më gjerë. Shanset për sukses në bisedimet e Rambujesë, në kohën kur situata në Kosovë po bëhej edhe më dramatike, ministri gjerman i Mbrojtjes Scharping, në prag të Konferencës së Mynihut për Politika të Sigurisë, më 7 shkurt, i vlerësonte me tone të përmbajtura “*në të mirë të 50 përqindëshit*” dhe mbrojtjen e vëzhguesve të OSBE-së e shihte urgjente, ndërsa intervenimin ushtarak të NATO-s, gjithnjë e më të mundshëm.<sup>30</sup>

Negociatat në Rambuje filluan me dy dokumente themelore: parimet themelore “të panegociueshme,” të përcaktuara nga GK dhe me projekt-dokumentin e Marrëveshjes së Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë. Konferenca drejtohej nga ekipi ndërmjetësues ndërkombëtar

<sup>28</sup> W. Petritsch, K. Kaser, R. Pichler, *Kosovo – Kosova ...*, f.280.

<sup>29</sup> Michael Dammann, *Internationale Bearbeitung des Kosovokonflikts 1990-1999*. Trier Arbeitspapiere zur Internationalen Politik, Nr. 3. Universität Trier: 2000, f.64.

<sup>30</sup> Rudolf Scharping, *Wir dürfen nicht wegsehen. Der Kosovo Krieg und Europa*, Berlin: 1999, f.51.

i përbërë nga përfaqësuesi i SHBA-së, ambasadori Christopher Hill, përfaqësuesi i BE-së, ambasadori austriak Wolfgang Petritsch dhe përfaqësuesi i Ruisë, Boris Majorski. Gjermania sikurse edhe në negociatat e Dejtonit, nuk mori një rol qendror në këtë konferencë. Duke vepruar në prapavijë ishin drejtori politik i MPJ të Gjermanisë, Günter Pleuger, dhe eksperti brilant për Ballkanin Christian Pauls.<sup>31</sup> Të dy palëve iu dha projekti fillestar me parimet e panegociueshme (*Non-Negotiable Principles*), të hartuara nga GK.<sup>32</sup> Këto parime përmbanin Marrëveshjen kornizë, aneksin kushtetues si dhe anekset për zgjedhjet dhe *Ombudspersonin* e propozuar, respektivisht autonomi substanciale për Kosovën dhe ruajtjen e integritetit territorial të Jugosllavisë së mbetur. Në fakt, pjesa politike e marrëveshjes ishte në duart e ndërmjetësuesve, por ishte bërë një përpjekje që palët të punonin duke ua dhënë copëzat e marrëveshjes kohë pas kohe. Vetëm 20% e elementeve bazë të planit konsiderohej si dokument që mund të negociohej. Sipas diplomatit të njohur gjerman Wolfgang Ishinger, kur delegacionet kishin arritur në Rambuje, të gjithëve u ishte bërë e qartë se kjo konferencë e paqes për Kosovën ishte mundësia e fundit për të arritur zgjidhje politike, përveç palëve në konflikt, të cilat ishin të pakompromis në pozicionet e tyre të kundërta.<sup>33</sup> Në këtë kohë, politika e jashtme gjermane ishte e orientuar mbi të gjitha për një qasje multilaterale gjithëpërfshirëse dhe për konceptin e saj tradicional të fuqisë civile, duke shpresuar se një konferencë e tillë e paqes do të shmangte përdorimin e forcës ushtarake. Për dallim nga politika reaktive e qeverisë së kancelarit H. Kohl, e cila u manifestua gjatë viteve të para të 90-tës dhe deri në shtator të vitit 1998, tani roli i politikës gjermane ishte mjaft aktiv, veçanërisht bie në sy bashkëpunimi i ngushtë në mes sekretares amerikane Madaleine Albright dhe ministrit të Jashtëm Fischer. Pavarësisht se Friedrich Roland thotë se shteti gjerman kishte një rol anësor dhe periferik<sup>34</sup> në radhët e pjesëmarrësve shqiptarë të Kosovës

<sup>31</sup> Wolfgang-Uwe Friedrich, "Kosovo and the Evolution of German Foreign Policy in the Balkans", në Wolfgang-Uwe Friedrich (editor), *The Legacy of Kosovo: German Politics and Policies in the Balkans*, Washington: The American Institute for Contemporary German Studies, 2000 (German Issues 22), f. 14.

<sup>32</sup> K. Kaser, W. Petritsch, R. Pichler, *Kosovo – Kosova ...*, f.280.

<sup>33</sup> Wolfgang Ischinger, "Kosovo: Germany Considers the Past and Looks to the Future", në *The Legacy of Kosovo: German Politics and Policies in the Balkans ...*, f. 33.

<sup>34</sup> R. Friedrich, *Die deutsche Außenpolitik im Kosovo-Konflikt ...*, f. 65.

ekziston mendimi se qëndrimi gjerman ishte korrekt, në sensin e bashkëpunimit të ngushtë me amerikanët lidhur me mënyrën e trajtimit të Kosovës, por një gjë e tillë bëhej pa u ekspozuar shumë dhe pa asnjë lloj protagonizmi.\* Pa dyshim, këtij qëndrimi aktiv të politikës gjermane i dha ton këmbëngulja dhe angazhimi personal i ministrit të Jashtëm gjerman, i cili ishte i vendosur të shfrytëzonte pozicionin e Gjermanisë si anëtare aktive e GK dhe si vend që mbante presidencën e radhës të BE-së dhe kryesuese e Grupit G-8. Ky bashkëpunim i ngushtë gjermano-amerikan hap pas hapi theu pozicionin dominues që kishin francezët dhe britanikët në fillim të konferencës dhe më pas iniciativën e morën amerikanët,<sup>35</sup> të cilët bashkë me gjermanët bënë trysni të madhe mbi palën shqiptare të Kosovës për firmosjen e marrëveshjes. Ndërkaq, evropianët dhe sidomos francezët,<sup>36</sup> në territorin e të cilëve ndodhte Konferenca e Rambujesë, insistonin me çdo kusht të bënin historinë, të arrinin paqe në mes shqiptarëve të Kosovës dhe Serbisë. Mirëpo, derisa evropianët shpresonin ta arrinin një gjë të tillë, amerikanët shfaqeshin më të përmbajtur dhe më skeptik për mundësinë që kjo konferencë do të prodhonte një marrëveshje të pranueshme për të dyja palët, pa përdorimin e forcës. Por, pas këmbënguljes së shteteve të BE-së dhe me qëllim të ruajtjes së kohezionit brenda GK, amerikanët do t'ia lënë nismën evropianëve në bisedimet e Rambujesë për çështjen e Kosovës, të cilat shumë shpejt treguan mundësitë e limituara të tyre si në rrafshin politik ashtu edhe ushtarak.<sup>37</sup> Për më tepër, për evropianët kjo konferencë ishte u shndërrua në një dëshirë për ta kthyer rastin e Kosovës në një testim të aftësisë së politikës së jashtme dhe të sigurisë të BE-së për menaxhimin e një krize në kufijtë e afërt të BE. Para së gjithash, vendet evropiane si Franca, dëshironin që përmes mbajtjes së kësaj konference në terrenin e saj t'i jepej vulë evropiane dhe mbi të gjitha franceze, zgjidhjes së çështjes së Kosovës. Për më tepër, kishte

\* Intervistë e autorit me Bujar Bukoshin, Prishtinë, 19 maj 2016.

<sup>35</sup> Çështja e Kosovës mban mbi vete shenjën e vendosmërisë amerikane, pa harruar se dështimi i Rambujesë ishte në thelb mospajtimi i një orvatjeje evropiane. Massimo D'Alema, *Kosova, italianët dhe lufta* (Intervistë e gazetarit Federico Rampini), Tiranë: Uegen, 2004, f.65.

<sup>36</sup> Dështimi i negociatave të kërkuara me aq vendosmëri nga Parisi shpjegon arsyen dhe vendosmërinë me të cilën francezët morën pjesë në operacione ushtarake. *Po aty*, f. 19.

<sup>37</sup> Blerim Shala, *Lufta diplomatike për Kosovën: dialog me ambasadorin Christopher Hill*, Prishtinë: Zëri, 2003, f. 94-95.

edhe një lloj egoje nacionale, që do të thotë se diplomacia franceze synonte të ishte më dominuese edhe në raport me partnerët evropianë, në këtë mes edhe ndaj Gjermanisë, edhe pse kjo e fundit në këtë periudhë mbante presidencën e BE, të G8-ës dhe të Bashkimit Evropian-Perëndimor (WEU). Kështu ndonëse Gjermania kishte këtë pozicion në forumet evropiane, roli i saj diplomatik u provua të jetë sa më periferik, për shkak të rivalitetit dhe garës që mbretëronte në mesin e shteteve evropiane për të luajtur rol dominues në një konferencë ndërkombëtare, e cila do të mbetej në histori, ashtu si shumë konferenca të tjera paraprake. Por falë angazhimit të vendosur të Fischer-it, pala gjermane që nga fillimi ishte pjesë e përgatitjes së katalogut të parimeve, të cilat do të përbënin bazën për bisedime në mes përfaqësuesve të Kosovës dhe të Serbisë.

Duke analizuar rrjedhën e Konferencës së Rambujesë, propozimet e ofruara dhe karakteristikat e negociatave, mund të konstatohen disa faza nëpër të cilat u zhvilluan negociata për arritjen e një zgjidhjeje paqësore për statusin kalimtar të Kosovës. Vëzhguesit e Konferencës kanë konstatuar se fillimin e bisedimeve në Rambuje e karakterizoi një qasje bllokuese e delegacionit serb, i cili nuk ishte i gatshëm të pranonte kurrfarë lloj autonomie për Kosovën. Për fatin e keq të bisedimeve, ky pozicion i ngurtë i palës serbe gjente mbështetje dhe tek ndërmjetësi rus Boris Majorski. Premisa serbe ishte që duke nënshkruar Marrëveshjen e Rambujesë, ata do ta humbisnin Kosovën. Atëherë Milosheviçi llogariste më mirë mundësinë e bombardimeve të kufizuara dhe ndërkohë të rifillonte bisedimet e, paralelisht me këtë vazhdonte të ndiqte politikën e tij represive kundër shqiptarëve të Kosovës. Kur NATO-ja i kishte vënë ultimatum Beogradit në lidhje me kushtet e Rambujesë për statusin e Kosovës, Milosheviçi kishte vendosur tashmë në Kosovë mbi 40 000 trupa ushtarake dhe të policisë speciale. Më pas do të kuptohet se ai kishte në posedim një plan, “*Operacionin Patkoi*”<sup>38</sup>, për dëbimin e qindra

<sup>38</sup> Gazeta gjermane “*Hamburger Abendblatt*” raportoi se “Dokumentet dorëzuar Joshka Fisherit” vinin nga një “material i pastrukturuar analitik të një agjenti të shërbimit informativ bullgar”, që kishte ardhur përmes Shërbimit Informativ Ushtarak Austriak tek ministri i Jashtëm të NATO-s. Shih: “Scharping gibt zu: Hufeisenplan liegt nicht schriftlich vor”, *Hamburger Abendblatt*, nr. 82, 6. April 2000 dhe Nadeshda Michajlowa, “Eine „starke Frau“ in Bulgariens Politik”, *Ost-West – Europäische Perspektiven*, 4/2002, von Johanna Deimel, “Scharping: Und den Hufeisenplan gab es doch”, *Der Spiegel*, 05.04.2000.

mijë shqiptarëve të Kosovës në Shqipëri dhe Maqedoni me qëllim që përmes këtij veprimi të destabilizonte këto vende dhe që më pas të çimentonte kontrollin mbi Kosovën.<sup>39</sup> Ky plan për ndryshimin e strukturës etnike në Kosovë ishte planifikuar të jetësohej brenda një kohe dhe përmes një fushate të vrasjeve dhe dëbimeve masive, meqë elita shtetërore serbe në Beograd vlerësonte se kërcënimet e NATO-s nuk ishin të besueshme, meqë llogaritej se Rusia do të bllokonte një hap të tillë përmes vetos së saj në Këshillin e Sigurimit. Ndaj, asokokohe mediat gjermane paralajmëronin se “po”-së së palës shqiptare për të negociuar planin e paqes në Rambuje, pala serbe do t’i përgjigjej me një varg destruksionesh, në mënyrë që procesi i bisedimeve të dilte nga binarët normalë dhe në këtë mënyrë t’i shmangej përgjegjësisë në rast se dështonte Konferenca. Po kështu, delegacioni serb në Rambuje iu përmbajt pikëpamjes së tij për refuzimin e pranisë së trupave të NATO-s në Kosovë, pasi kjo, sipas Beogradit, cenonte sovranitetin dhe integritetin tokësor të Jugosllavisë së mbetur. Madje vetëm dy ditë para fillimit të Konferencës në Rambuje, Parlamenti Serb kishte miratuar vendime në lidhje me “agresionin kërcënues të NATO-s dhe se në asnjë rrethanë nuk do të pranohej dislokimi i ushtarëve të huaj në territorin serb”.<sup>40</sup>

Në anën tjetër, delegacioni i shqiptarëve të Kosovës, duke patur një përfaqësim më të lartë politik dhe ushtarak, megjithë dallimet e brendshme të vogla, demonstroi një qasje serioze në trajtimin e marrëveshjes së propozuar dhe të gjitha propozimeve të mëvonshme. Por, ky unitet ishte edhe i imponuar, meqë kërcënimi politik i NATO-s ndaj Kosovës ishte më i frikshëm në rast se do të refuzonte të nënshkruante Marrëveshjen e Rambujesë. NATO-ja, përfshirë edhe Gjermaninë, kishin paralajmëruar bllokimin e financave për UÇK-në, dhe me këtë ata do të tërhiqeshin nga angazhimi i tyre për zgjidhjen e krizës. Në rrethanat e situatës ushtarake *vis-a-vis*, për Jugosllavinë e mbetur, shpresa e vetme për të arritur diçka në fushën politike ishte përfshirja e qendrave ndërkombëtare të vendosjes, përkrahja e së cilës ishte vendimtare në luftën e armatosur. Prandaj, humbja eventuale e mbështetjes ndërkombëtare do të shpinte në mosrealizimin e objektivës kryesore

<sup>39</sup> Eric A Witte, "Der Wiederaufbau des Kosovo: die ethnische Dimension", në Joachim Krause, *Humanitäre Intervention und kooperative Sicherheit in Europa*, Opladen: 2000, f.174.

<sup>40</sup> *Službeni Glasnik Republike Srbije*, nr. 4, 4 shkurt 1999; Jens Reuter, "Die Kosovo-Politik der internationalen Gemeinschaft in den neuziger Jahren ...", f. 328.

politike në procesin e ndërkombëtarizimit të krizës së Kosovës.<sup>41</sup> Në këtë kuptim, kërcënimi i NATO-s dhe kërkesa e GK, ku bënte pjesë edhe Gjermania, influencuan qëndrimin e delegacionit shqiptar në Konferencën e Rambujesë. Realisht, nuk kishte opsion tjetër pos të pranohej marrëveshja e paqes si një zgjidhje kalimtare. Sidoqoftë, ekzistonte premtimi se pas një periudhe kalimtare trevjeçare do të përcaktohej statusi përfundimtar i Kosovës.

Këto dy qasje diametralisht të kundërta në mes palës shqiptare dhe serbe bënë që bisedimet e Rambujesë të mos shënojnë përparim. Në këtë rrethanë, GK në takimin ministror në Paris, më 14 shkurt 1999, me insistimin amerikan mori vendim për vazhdimin e bisedimeve. Në fakt, me këtë qëndrim u bë e mundur të ndihmoheshin shqiptarët e Kosovës, meqë dështimi i Konferencës do të prishte kohezionin e shteteve anëtare të GK lidhur me angazhimin e tyre në çështjen e Kosovës.<sup>42</sup> Si kryesuese e radhës të BE-së, ministri i Jashtëm gjerman Fischer, duke dashur t'i jepte ton evropian rrjedhës së Konferencës së Rambujesë, në rezidencën e ambasadorit gjerman në Paris, në pallatin mbresëlënës Beauharnais, thirri një takim informues me të gjithë ministrat e jashtëm të shteteve anëtare, ku katër ministrat e jashtëm të shteteve anëtare të BE-së, Britania e Madhe, Franca, Italia dhe Gjermania, shtete këto të përfshirë në negociatat e Rambujesë, do të raportnin dhe t'u jepnin llogari nevojave legjitime për informim dhe prestigj shteteve më të vogla anëtare. Synohej të shmangeshin kundërrthëniet e panevojshme në radhët e BE-së dhe që ajo edhe në të ardhmen të paraqitej me një qëndrim unik dhe konsekuent për çështjen e Kosovës.<sup>43</sup> Ishte e qartë se diplomacia gjermane provonte të ushtronte ndikimin e saj në formulimin e qëndrimeve të GK dhe të BE-së lidhur me mbarëvatjen e Konferencës së Rambujesë dhe mënyrën e zgjidhjes së krizës në Kosovë. Kjo shpërfaqet edhe në nismën tjetër të ministrit Fischer që menjëherë pas takimit me homologët e shteteve anëtare të BE-së, të cilët i dhanë mbështetje linjave thelbësore të Konferencës së Rambujesë, ministrat e tjerë të Jashtëm të përfshirë në negociatat në Rambuje, të takoheshin me delegacionet e palëve në konflikt, me qëllim të bindeshin për ta pranuar marrëveshjen kalimtare për Kosovën. “*Shqiptarët e Kosovës kërkonin në mënyrë këmbëgulëse*

<sup>41</sup> M. Weller, *Contested Statehood ...*, f.121.

<sup>42</sup> B. Shala, *Lufta diplomatike për Kosovën ...*, f.94-95.

<sup>43</sup> J. Fischer, *Die rot-grünen Jahre ...*, f.137.

pavarësinë nga Serbia dhe në shtegun deri në atë pikë, kërkonin përcaktimin e datës për organizimin e referendumit që do të obligonte bashkësinë ndërkombëtare,”<sup>44</sup> shkruan Fischer, duke nënvizuar se shqiptarët e kishin të qartë se një referendum i tillë do të përfundonte me shumicë absolute në favor të pavarësisë. Në këtë pikë, diplomacia gjermane, ashtu si edhe ajo e vendeve të tjera të BE-së dhe të GK, nuk e përkrahte këtë qëllim parësor strategjik të shqiptarëve, shkëputjen e Kosovës nga Jugosllavia e mbetur, por vetëm “rivendosjen e vetëqeverisjes, apo autonomisë përmbajtësore.” Mirëpo, nga ajo çfarë shkruan ministri i Jashtëm gjerman, ai nuk e përjashtonte opsionin e pavarësisë së Kosovës, por se ishte përpjekur që t’ia shpjegonte përfaqësuesve të delegacionit shqiptar se pavarësia nuk mund të arrihej në mënyrë të drejtpërdrejtë, por se ai ishte një proces dhe që duhej të ndërlihej me zhvillimet në rajon dhe procesin e integritetit evropian. Sipas tij, për shqiptarët e Kosovës kjo nënkuptonte pranimin e një statusi gjithëpërfshirës autonom për një periudhë kalimtare dhe një prani të fuqishme ushtarake të NATO-s në Kosovë, si shans i vetëm për realizimin e aspiratave të tyre.<sup>45</sup> Kjo zgjidhje që ofrohej përmes këtyre parimeve nënkuptonte një nivel më të ulët të autonomisë sesa ajo që kishte pasur Kosova me Kushtetutën e vitit 1974 në kuadër të Jugosllavisë Federative<sup>46</sup>, e hequr me forcë nga Milosheviçi. Pikërisht për këtë arsye, delegacioni i Kosovës argumentonte me këmbëngulje se në pajtim me karakterin e përkohshëm të Marrëveshjes, duhej pasur një dispozitë që do të parashihte mbajtjen e një konference ndërkombëtare për zgjidhjen përfundimtare për statusin e Kosovës, që do të mbështetej në “vullnetin e popullit” të shprehur përmes referendumit.<sup>47</sup>

Në mesin e javës së dytë të bisedimeve të Rambujesë u bë e qartë se situata kishte hyrë në qorrsovak diplomatik, meqë pala serbe në asnjë mënyrë nuk ishte e gatshme të lejonte një prani të fuqishme ushtarake në

<sup>44</sup> *Po aty*, f.138.

<sup>45</sup> *Po aty*.

<sup>46</sup> S. Ukshini, *Kosova dhe Perëndimi ...*, f.206.

<sup>47</sup> Ministri i Jashtëm gjerman, në kujtimet e tij lidhur me synimet e shqiptarëve të Kosovës për pavarësi, shkruan: “Politika shumëvjeçare e shtypjes kundër shumicës shqiptare të Kosovës kishte nxitur shkëputjen, e kishte bërë të pashmangshme që të gjithë shqiptarët e Kosovës tashmë të ishin unik për çështjen e pavarësisë. Për asnjë çmim në botë, ata nuk dëshironin të mbeteshin më nën pushtetin serb. Milosheviçi ishte pak para momentit që të humbte përgjithmonë Kosovën”. Më gjerësisht shih: J. Fischer, *Die rot-grünen Jahre ...*, f.138.

Kosovë, respektivisht një forcë ushtarake të NATO-s. Ata e mbronin këtë qëndrim pavarësisht se ishte e qartë që Marrëveshja e Rambujesë reflektonte kërkesën e Serbisë dhe të Jugosllavisë së mbetur që në Kosovë të mbetej prezenca ushtarake dhe policore serbe, ndonëse me kufizime të theksuara. Pjesa ushtarake e draftmarrëveshjes parashikonte një demilitarizim të konsiderueshëm. Pala serbe duhej t'i ulte numrin e trupave të saj ushtarake në Kosovë nga 10.000 në 1.500 trupa të rregullta dhe, forcën e policisë speciale ta reduktonte në 2.500 trupa. Përveç kësaj, ajo duhej të mënjanonte sistemin e mbrojtjes ajrore të stacionuar në Kosovë, në anën tjetër edhe luftëtarët e UÇK-së të hiqnin dorë nga armët e tyre.<sup>48</sup>

Bisedat insistuese me të dyja palët ishin të kota dhe se palët në konflikt nuk kishin lëvizur nga pozicionet e tyre diametralisht të kundërta.<sup>49</sup> Ky ishte një moment vendimtar politik që e shtyu Uashingtonin të ndërhynte bilaterisht, pasi nuk ishte i gatshëm të toleronte taktikën serbe të refuzimit.

Në planin kombëtar, në kabinetet e qeverisë federale shkëmbeheshin shpesh dhe në mënyrë të detajuar informacionet mbi kontaktet e shumta dhe të dendura brenda qeverisë federale, midis ministrave dhe kancelarit federal, duke përfshirë kryesuesit e fraksioneve federale. Kështu për shembull, treshja e njohur e "luftës" Schröder, Fischer, Scharping informonte hollësisht dhe deri në detaje kryetarët e fraksioneve rreth vlerësimit të situatës politike, mbi vazhdimin, thënë më mirë, dështimin kërcënues, të bisedimeve në Rambuje dhe të pasojave. Përtjashtuar të majtën ekstreme, politika federale gjeti mbështetje lidhur me çështjen e përbërjes së trupës paqeruajtëse të NATO-s si forcë implementuese e marrëveshjes dhe nevoja e kontributit gjerman për këtë, planifikimet tjera të NATO-s për mundësinë e operacioneve të shkallëzuara ajrore.<sup>50</sup>

Në planin e jashtëm, pala gjermane kishte mbledhur informacionet rreth situatës në Kosovë edhe përmes kontakteve të kancelarit federal Schröder me shefat e shteteve dhe të qeverive në BE-së dhe në NATO dhe po kështu përmes kontakteve të ministrit të Jashtëm Fischer me kolegët e tij. Në kontakte me partnerët në BE dhe në NATO bisedohej intensivisht

<sup>48</sup> Interim Agreement for Peace and Self-Government In Kosovo – Rambouillet, France - February 23, 1999; M. Weller, *Contested Statehood ...*, f.144-145.

<sup>49</sup> J. Fischer, *Die rot-grünen Jahre ...*, f.139.

<sup>50</sup> R. Scharping, *Wir dürfen nicht wegsehen ...*, f.54-55.

lidhur me mundësitë që të vazhdoreshin angazhimet për një zgjidhje paqësore dhe mbi atë se çfarë përgjegjësie mban Gjermania, për të forcuar kohezionin në Aleancë. Po kështu, pala gjermane vazhdonte angazhimet e saj për të bindur Rusinë që të përfshihej në procesin e bërjes së paqes. Faktikisht kjo nuk nënkuptonte asgjë tjetër përveçse një të drejtë vetoje për politikën e Milosheviçit. Qëllimi i qeverisë gjermane e koalicionit kuq-gjelbër vazhdonte të ishte përpjekja për mbajtjen e Rusisë në procesin negociues të Rambujesë dhe zgjidhja e çështjes së Kosovës pa angazhimin ushtarak të NATO-s. Ky qëndrim i palës gjermane puqej po ashtu me kursin e presidentit të moderuar rus Boris Jelcin, i cili, në kohën kur po përballej me trysninë e Dumës ruse për shkak të çështjes së Kosovës, në politikën e jashtme kërkonte prestigj.<sup>51</sup> Në veçanti në lidhje me krizën në Kosovë, nuk mund të flitej për politikë unike të qeverisë ruse, për shkak të kundërtënieve që ekzistonin në mes Kremlinit, Ministrisë së Jashtme ruse dhe asaj të Mbrojtjes.<sup>52</sup>

Në mënyrë të ngjashme, Fischer ushtroi trysni edhe mbi palën shqiptare, respektivisht mbi Thaçin,<sup>53</sup> si përfaqësues kryesor i krahut politik të UÇK-së, pasi ishte e madhe mundësia që edhe delegacioni nga Kosova të mos e pranonte marrëveshjen, sepse fillimisht nuk ekzistonte gatishmëri që të hiqej dorë nga pavarësia e Kosovës dhe referendumi obligues, si dhe as të jepej pëlqimi për shpërbërjen e UÇK-së.<sup>54</sup> Kjo ishte faza më intensive e negociatave në Rambuje dhe strategjia e ndërmjetësve në këtë fazë përmbyllëse të Konferencës kishte si intencë që të paktën të arrihej “për të pajtuar të papajtueshmit”, siç do të thoshte ndërmjetësi amerikan Christopher Hill.<sup>55</sup> Prandaj, në mënyrë të alternuar u zhvilluan negociata të gjata dhe me plot tension me të dyja palët me qëllim që të detyroheshin për të bërë lëshime graduale. Sipas ministrit të Jashtëm gjerman, këto negociata, sidomos pas vizitës së Hill-it në Beograd më 16 shkurt, gjithnjë e më shumë përcaktoheshin nga strategjia negociuese e SHBA-së. Kjo strategji në atë, që me përfundimin e

<sup>51</sup> Boris Jelcin: *Mitternachtstagebuch. Meine Jahre im Kreml*, Propyläen Verlag, Berlin – München: 2000, f.243-256.

<sup>52</sup> J. Fischer, *Die rot-grünen Jahre ...*, f.141.

<sup>53</sup> W. Petritsch, K. Kaser, R. Pichler, *Kosovo/Kosova ...*, f.301.

<sup>54</sup> J. Fischer, *Die rot-grünen Jahre ...*, f.142; R. Scharping, *Wir dürfen nicht wegsehen ...*, f.56.

<sup>55</sup> Matthias Rüb, *Kosovo. Ursachen und Folgen eines Krieges in Europa*, München: 1999, f.107.

negociatave në Rambuje, delegacioni i shqiptarëve të Kosovës të bindej po atë ditë që të pranonte dokumentin përfundimtar, për të izoluar në këtë mënyrë qeverinë serbe dhe për të krijuar kështu një trysni maksimale ndaj Beogradit, në mënyrë që Milosheviçi në fund të detyrohej që të lëshonte pe, apo, në rast se refuzonte marrëveshjen, të bëhej përgjegjës para gjithë botës për konfrontim ushtarak me NATO-n.<sup>56</sup> Gjithashtu, të dyja palëve në Konferencën e Rambujesë më në fund iu paraqit shtojca ushtarake e Marrëveshjes,<sup>57</sup> pa pjesëmarrjen e ndërmjetësit rus Boris Majorski, por duke qenë në dijeni, pasi Rusia e kishte bërë të qartë se nuk do të merrte pjesë në bisedime, për pjesën ushtarake, pa marrë një sinjal pozitiv të Beogradit. Ky kishte qenë qëndrimi rus edhe në Konferencën e Dejtonit.

Meqë negociatat në Rambuje nuk shënonin përparim dhe për pjesëmarrësit e saj nuk ishte i qartë përfundimi, diplomacia gjermane sërish ndërmori përpjekjen për të afruar në një linjë palët në konflikt. Boni zyrtar dëshironte që sërish të mbyllte shtegun për një luftë të NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur. Një javë më pas në Bundestag ministri i Jashtëm J. Fischer ishte shprehur se, për të personalisht “orët e të shtunës së fundit në Rambuje, kur krejtësisht ishte e hapur, nëse do të thoshte luftë apo paqe, kishin qenë më të rëndat”.<sup>58</sup> Ai shtonte po ashtu: “Pasi unë atje u takova me papajtueshmërinë e palëve, veçanërisht të përfaqësuesve të qeverisë së Beogradit, e kam vënë re qartë se si këtu tek disa pjesëmarrës nuk ekzistonte interesimi për fatin e njerëzve dhe për paqe, por në plan të parë ishte ruajtja e pushtetit si dhe dhuna, vrasjet dhe krejt natyrshëm, lufta, si kalkulim politik. Ndaj, po ju them unë: Qëndrimi indiferent nënkupton pranimin e kësaj logjike vrastare.”<sup>59</sup> Në këtë mënyrë, Fischer në masë të madhe bënte përgjegjëse qeverinë serbe për dështimin e Konferencës. Në të njëjtën kohë duhej të merrej parasysh se të paktën përfaqësuesit e krahut ushtarak sigurisht duhej të llogarisnin po ashtu “dhunë, vrasje dhe luftë”, në rast se Konferenca do të përfundonte pa sukses.

Kur dukej se bisedimet kishin hyrë në rrugë qorre, BE-ja, nën drejtimin e presidencës gjermane, doli me një plan të hollësishëm që

<sup>56</sup> J. Fischer, *Die rot-grünen Jahre ...*, f.141.

<sup>57</sup> Shtojca B mbështetej plotësisht në precedencën e forcave të IFOR/SFOR-it në Bosnjë-Hercegovinë dhe operacionet paqeruajtëse të Kombeve të Bashkuara. M. Weller, *Sontested Statehood ...*, f.145.

<sup>58</sup> Deutscher Bundestag: Plenarprotokoll 14/22 vom 25.02.1999, f. 1704.

<sup>59</sup> *Po aty*.

përmbante hapat dhe kalendarin e saktë kohor të heqjes së sanksioneve ndaj Jugosllavisë së mbetur. Sipas dokumentit strategjik të hartuar nën kryesinë gjermane, në ditën që do të nënshkruhej Marrëveshja e Rambujesë, do të ndodhte heqja e sanksioneve ndaj shoqërisë ajrore shtetërore serbe JAT. Heqja e masave të tjera shtrënguese ekonomike dhe ligjore ndaj Beogradit do të bëhej duke ndjekur hapat e zbatimit të marrëveshjes. Me këtë hap pala gjermane dhe BE-ja përpiqeshin për ta nxitur palën serbe që të nënshkruante marrëveshjen dhe në këtë mënyrë të hapte rruga për rikthimin e Jugosllavisë së mbetur në institucionet evropiane dhe ndërkombëtare brenda dy vjetësh. Por, delegacioni serb mbeti në refuzimin e tij kundër çdo implementimi ushtarak përmes trupave ndërkombëtare, veçanërisht nga NATO-ja.<sup>60</sup>

Në të njëjtën kohë, ministri i Jashtëm gjerman dhe ndërmjetësi i BE-së bënë trysni mbi kryesuesin e delegacionit të Kosovës, Hashim Thaçi, për të marrë nga ai miratimin për çështjen e pranimit të marrëveshjes. Po ashtu, pak para mbarimit të afatit të konferencës, ministri i Jashtëm gjerman në cilësinë e kryesuesit të Këshillit të BE-së, i drejtoi një thirrje të fundit urgjente Milosheviçit. Me anën e një letre ai i tërhoqi vëmendjen edhe një herë udhëheqësit serb për rëndësinë e vendimit të pritshëm, të cilin mund ta merrte vetëm ai, për të zgjedhur midis paqes, kaosit të brendshëm dhe izolimit ndërkombëtar.<sup>61</sup> Më tej, Fischer, në emër të presidencës gjermane të Këshillit të BE, urgjentisht apelonte që Milosheviçi të shfrytëzonte këtë mundësi të fundit dhe të pranonte zgjidhjen e propozuar të paqes brenda afatit të përcaktuar nga GK, duke tërhequr vërejtjen se pasojat e dështimit të procesit të paqes do të kenë një çmim të lartë për Jugosllavinë. Duke dashur ta inkurajonte Milosheviçin që të nënshkruante marrëveshjen, shefi i diplomacisë gjermane theksonte edhe një herë se sovraniteti dhe integriteti territorial i Jugosllavisë së mbetur janë baza të padiskutueshme e procesit politik për zgjidhjen në mënyrë paqësore të këtij konflikti, një proces në të cilin BE ka luajtur një rol kyç. Në të njëjtën kohë, Fischer në letrën e tij theksonte se për zbatimin e marrëveshjes në mënyrë të pashmangshme duhej të përfshihej edhe një prezencë ushtarake ndërkombëtare, e cila do të kontribuonte në mënyrë thelbësore në drejtim të përmirësimit të gjendjes

<sup>60</sup> Dossier "Wie Deutschland in den Krieg geriet", në *Die Zeit*, 12. 5 1999, f. 21. Interim Agreement for Peace and Self Government in Kosovo, 22. Februar 1999, Appendix B, Nr. 8, f. 77.

<sup>61</sup> W.Petritsch, K. Kaser, R. Pichler, *Kosovo – Kosova ...*, f. 306-308.

së sigurisë në Kosovë. Në këtë kontekst, ai e siguronte Milosheviçin se një nga detyrat kryesore të pranisë ndërkombëtare do të ishte monitorimi i demobilizimit të ashtuquajturës UÇK.<sup>62</sup>

Në këto rrethana, më 23 shkurt 1999, GK pa shumë zhurmë i shpalli konkluzionet për ecurinë e Konferencës së Rambujesë, ku në mes të tjerash, konstatohej se ishte arritur konsensusi për një autonomi reale, për mekanizmat e zgjedhjes së institucioneve demokratike, për të drejtat e njeriut dhe për krijimin e sistemit gjyqësor. Pasi Konferenca e Rambujesë u përmbyll pa arritur një marrëveshje përfundimtare, dy palët dhe GK ranë dakord për të vazhduar bisedimet më 15 mars 1999,<sup>63</sup> duke shprehur se në ndërkohë në Beograd do të sqaroheshin çështjet e mbetura pezull me delegacionin serb. Për të gjithë ishte e qartë se rezultati i Konferencës varej nga qëndrimi i Beogradit.

Mund të konkludohet se gjatë rrjedhës së negociatave u bë evidente se kishte tre nivele të negociatave: *Së pari*, negociatat kyçe, në të cilat nga Grupi i Kontaktit do të merrnin pjesë vetëm Shtetet e Bashkuara, Franca dhe Britania e Madhe, si dhe palët në konflikt. *Së dyti*, ato më pak të rëndësishme, kryesisht vetëm për konsultime shërbenin tryezat e rrumbullakëta me përfshirjen e Gjermanisë dhe Italisë, si dhe Përfaqësuesi Special i BE, ambasadori austriak Wolfgang Petritsch. *Së treti*, pothuajse ekskluzivisht për informacione dhe sqarime me përfshirjen edhe të përfaqësuesit të Rusisë. Dhe *së katërti*, përjashtimi konsiderueshëm i gjermanëve, të cilët të paktën e kishin presidencën e radhës të BE-së dhe për këtë arsye në kuadrin e Politikës së Përbashkët të Jashtme dhe të Sigurisë (PPJS) do të duhej të kishin një rol kryesor, përceptohej si ofenduese dhe e papranueshme.<sup>64</sup> Pavarësisht këtij pozicioni anësor të diplomacisë gjermane, ajo ishte e interesuar që ta mbante Rusinë në bord, pasi, nëse Konferenca e Rambujesë do të dështonte dhe do të pasonte intervenimi i armatosur i NATO-s, atëherë ishte me rëndësi që rusët me të drejtë vetoje në OKB të mos rreshtoheshin kundër përpjekjeve ndërkombëtare në Kosovë. Ky angazhim i qeverisë gjermane determinohej edhe për shkak të arsyeve ligjore, ashtu edhe për arsye politike, që të ndërmernte çdo përpjekje, që gjatë zgjidhjes së krizës së Kosovës të mos dilej nga kornizat e OKB-

<sup>62</sup> *Po aty*.

<sup>63</sup> S. Ukshini, *Kosova dhe Perëndimi ...*, f. 200.

<sup>64</sup> J. Krause, *Deutschland und Kosovo-Krise ...*, f. 410.

së.<sup>65</sup> Dhe nëse shikohet nga ky këndvështrim, atëherë roli i Gjermanisë nuk mund të cilësohet krejt periferik dhe kjo do të shpërfaqet edhe pas Rambujesë, kur Boni zyrtar dominoi me iniciativën diplomatike. Ndaj deri në fillimin e raundit të dytë të Konferencës për Kosovën, Gjermania, ashtu si gjatë gjithë konferencës, bëri të gjitha përpjekjet për të bindur palën shqiptare qoftë nëpërmjet negociatorit të BE-së dhe përfaqësuesve të saj në ekipin e tij, ashtu edhe përmes angazhimit personal të Fisherit. *“Ne duam paqe në Kosovë, paqja do të thotë nënshkrim i marrëveshjes së Rambujesë dhe paqe do të thotë që forcat paqësore ndërkombëtare të udhëhequra nga NATO-ja duhet të implementojë këtë paqe,”*<sup>66</sup> deklaronte Fischer, pak ditë pas Rambujesë. Politika gjermane mbante shpresa të mëdha se do të kishte nënshkrim nga pala shqiptare për marrëveshjen e Rambujesë dhe për këtë po punonin me faktorin politik për të marrë qartësi të plotë nga shqiptarët e Kosovës. Në anën tjetër, me UÇK-në po punonin amerikanët përmes ndërmjetësit të tyre Christopher Hill, meqë dështimi në Kosovë do të përceptohej më shumë si disfatë e amerikanëve e jo e NATO-s.

Në këtë periudhë, mund të konstatohet se Gjermania, krahasuar me vendet e tjera evropiane të GK, ishte më afër pozicionit të SHBA-së dhe kjo qasje ishte si rrjedhojë e bashkëpunimit dhe koordinimit të ngushtë midis sekretares amerikane M. Albright dhe J. Fischer. Pra, politika dhe shteti gjerman luajti një rol aktiv, por jo shumë të ekspozuar. Ndoshta për këtë arsye autorë të ndryshëm rolin e shtetit gjerman e vlerësojnë si periferik dhe dytësor. Për më tepër, Konferenca e Rambujesë nxori në sipërfaqe edhe një lloj gare për primat dhe prestigj politik të Britanisë së Madhe dhe sidomos Francës, mbase edhe për faktin se në këtë vend po zhvillohej konferenca për Kosovën. Kjo atmosferë ishte shpërfaqur qysh në janar 1999 në takimin e drejtorëve politikë të Grupit të Kontaktit, kur kryesuesi bëri propozimin për formatin e pjesëmarrjes në Konferencën e paqes për Kosovën.

### ***Shuttle diplomacy (diplomacia ndërmjetësuese) e Fischer-it***

<sup>65</sup> J. Fischer, *Die rot-grünen Jahre ...*, f.132-133.

<sup>66</sup> “Ministri i Jashtëm gjerman viziton Kosovën dhe takohet me liderët shqiptarë të Kosovës”, në *Koha Ditore*, 09.03.1999.

Pas përfundimit të Konferencës së Rambujesë, Gjermania mori plotësisht një rol aktiv në fazën e ndërmjetme të *shuttle diplomacy*.<sup>67</sup> Të gjitha përpjekjet në vazhdim u përqëndruan për afrimin e palëve kundërshtarë para rifillimit të bisedimeve në Paris, më 15 mars 1999. *Shuttle diplomacy* shihej si shansi i fundit për shmangien e sulmeve ajrore të NATO-s kundër objektivave ushtarake dhe represive të Jugosllavisë së mbetur. Për këtë gjatë fillimmuajit mars ministri i Jashtëm gjerman Fischer, diplomatët amerikanë Holbrooke dhe Hill, dhe ministri i Jashtëm rus Ivanov ndërmorën përpjekje për të bindur lidërshtarin serb në Beograd që të lëshonte pe dhe të pranonte planin e paqes.<sup>68</sup>

Pasi UÇK-ja, më 2 mars 1999, kryenegociatorin e delegacionit të Kosovës në Rambuje, Hashim Thaçi, e kishte emëruar në postin e Kryeministrit të Kosovës, i ngarkuar për formimin e një qeverie të përkohshme, përfaqësuesi i deriatëhershëm politik i UÇK-së, Adem Demaçi, një kundërshtar i madh i procesit të Rambujesë, dha dorëheqjen.<sup>69</sup> Prandaj, SHBA-të ia arritën "që të bindin UÇK-në dhe me këtë edhe tërë delegacionin negociues të shqiptarëve të Kosovës për nënshkrimin e marrëveshjes."<sup>70</sup> Po ashtu, liderët shqiptarë të Kosovës shpresonin se NATO-ja do të angazhohej në luftë në anën e tyre, vetëm nëse ata do ta nënshkruanin marrëveshjen dhe serbët do ta refuzonin atë.

Milosheviçi refuzonte sidomos stacionimin e trupave paqëruajtëse ndërkombëtare në Kosovë. Në fakt, menjëherë pas Rambujesë në Beograd ishte marrë vendimi politik bazë, sipas të cilit, i gjithë progresi që ishte arritur në Rambuje, tërhiqej prapa përsëri. Beogradi, deri me rifillimin e bisedimeve në Paris, nuk lëvizti nga ky pozicion. Ky qëndrim refuzues i Milosheviçit tregonte qartë se ai ishte i vendosur të hidhte poshtë procesin e Rambujesë si mundësi për zgjidhjen paqësore të

<sup>67</sup> **Shuttle diplomacy** janë negociatat e kryera nga një ndërmjetës i cili udhëton në mes të dy ose më shumë palëve që janë të gatshëm për të zhvilluar diskutime të drejtpërdrejta.

<sup>68</sup> "Holbrooke soll Druck auf Belgrad weiter erhöhen", në *FAZ*, 10.03.1999.

<sup>69</sup> Predrag Jureković, "Die politische Dimension des Krieges im Kosovo und in der BR Jugoslawien: Konfliktentwicklung, politische Initiativen der Staatengemeinschaft, Auswirkungen auf das Umfeld", në Erich Reiter(Hrsg.), *Der Krieg um das Kosovo*. Mainz: 2000, f.61; Berthold Meyer & Peter Schlotter, *Die Kosovo-Kriege ...*, f. 22-23.

<sup>70</sup> Matthias Rüb, "Phönix aus der Asche" Die UÇK: Von der Terrororganisation zur Bodentruppe der Nato?" në Thomas Schmid(Hrsg.), *Krieg im Kosovo*, Reinbeck: 1999, f.61.

çështjes së Kosovës. Një pozicion i tillë i Beogradit u shpërfaq edhe gjatë bisedimeve konsultive në mes të ambasadorit austriak Wolfgang Petritsch, si i dërguar i BE-së dhe ambasadorit gjerman Christian Pauls, me zv/kryeministrin Nikolla Shainoviqit,<sup>71</sup> njeriu shumë i besuar i Milosheviçit.<sup>72</sup> Sidoqoftë, Petritsch dhe Pauls përsëri i bënë të qartë pozicionin e GK, sipas të cilit gjatë vazhdimit të negociatave në Paris, më 15 mars do të diskutohet vetëm për çështjen e zbatimit. Në të njëjtën kohë i ishte bërë e qartë Beogradit se pjesa politike e marrëveshjes konsiderohej e mbyllur dhe se vetëm disa çështje të natyrës teknike do të qartësoheshin.<sup>73</sup>

Qeveria federale gjermane shfrytëzoi kontaktet e saj për të negociuar edhe me palën shqiptare. Në të njëjtën ditë, Petritsch dhe Pauls, pa shënuar ndonjë përparim në Beograd, shkuan në Kosovë për t'u takuar me drejtuesit e Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Në këtë takim ata bënë edhe një herë të qartë me vendosmëri se me pranimin e marrëveshjes duhej të pranohej çmilitarizimi i plotë i UÇK-së. Për ndërmjetësuesit ishte e rëndësishme të shihnin nga afër reagimin e komandantëve të UÇK-së, të cilët nuk e kishin të lehtë ta ndërmerrnin një hap të tillë, ndërsa për krahun politik një hap i tillë ishte më i lehtë, meqë ata parashikonin të luanin një rol të rëndësishëm politik në të ardhmen. Në ditët vijuese Hashim Thaçi, i cili nuk kishte qenë personalisht në takim, nga pozicioni i tij si përfaqësues i UÇK-së dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm, i kishte njoftuar zyrtarët gjermanë se UÇK-ja do të jepte një përgjigje pozitive lidhur me marrëveshjen dhe se ishin të gatshëm për nënshkrimin e saj gjatë bisedimeve në Paris.<sup>74</sup> Paralelisht, ministri i Jashtëm gjerman dhe kryesuesi i Këshillit të BE-së, më 8 mars ndërmori një përpjekje të mëtejshme për ndërmjetësim në Beograd, në Prishtinë, në Shkup dhe në Tiranë. Natyrisht, ky ishte një sinjal se lidhshipi serb po përgatitej për një fushatë masive ushtarake kundër shqiptarëve të Kosovës. Siç kujton Fischer, Milosheviçi gjatë gjithë kohës “më shikonte me një shprehje të fytyrës, sikur dëshironte të thoshte se ai është i

<sup>71</sup> K.Kaser, W.Petritsch, R.Pichler, *Kosovo – Kosova ...*, f.324.

<sup>72</sup> “Shainoviq ishte njeri i besuar i Millosheviçit, thotë Surroi”, *KosovaPress*, 10 tetor 2006;

<http://www.kosovapress.com/sq/arkiva/shainoviq-ishte-njeri-i-besuar-i-millosheviçit-thote-surroi-7859/?old=1>

<sup>73</sup> K.Kaser, W.Petritsch, R.Pichler, *Kosovo – Kosova ...*, f. 326.

<sup>74</sup> *Po aty*; “Albanar-Führer Demaçi tritt zurück”, në *FAZ*, 03.03.1999.

gatshëm të ecë mbi kufoma, gjë që e ka dëshmuar shpesh, dhe se Perëndimi, para së gjithash Evropa, nuk është e gatshme ta bëjë këtë.”<sup>75</sup> Fischer u përgjigj duke ngulur këmbë se nënshkrimi i Marrëveshjes së Rambujesë ishte mundësia e fundit për zgjidhjen e krizës së Kosovës në kuadrin e përpjekjeve diplomatike evropiane. Dhe në lidhje me zbatimin e marrëveshjes, ministri gjerman shprehu vendosmëri se ajo do të zbatohet me ndihmën e një force paqësore ndërkombëtare të udhëhequr nga NATO-ja.<sup>76</sup> Ashpërsim i sërishëm i pozicionit të palës serbe tregoi se ishin iluzore pritjet e krijuara në fazën përmbyllëse të Rambujesë se Beogradi do të mund të pranonte marrëveshjen e paqes, madje Milosheviçi kishte dhënë shenja të qarta se po përgatitej për ofensivë të madhe në Kosovë dhe, për këtë kishte dislokuar trupat ushtarake dhe njësitë policore speciale në Kosovë. Në fakt, një vit para fillimit të sulmeve ajrore të NATO-s, regjimi i Milosheviçit kishte filluar taktikën e tij vrastare përmes masakrave dhe dëbimeve masive. Kjo politikë kishte vijuar, pavarësisht paralajmërimeve kërcënuese të GK për sanksione politike dhe ekonomike ndaj Beogradit, në rast se autoritetet serbe nuk e ndalonin represionin dhe fushatën ushtarake në Kosovë,<sup>77</sup> Milosheviçi vazhdonte përqendrimin e trupave ushtarake dhe policore në zonën kufitare midis Kosovës dhe Maqedonisë, si kundërpërgjigje ndaj marshimit të mundshëm të NATO-s nga territori i Maqedonisë. Situata u bë edhe më kritike pasi forcat ushtarake dhe policore serbe gjatë operacioneve ushtarake kundër popullsisë shqiptare dogjën dhe shkatërruan gjithandej fshatrat dhe dëbuan një popullsi të tërë.<sup>78</sup>

### Vazhdimi i konferencës në Paris

Me problemet lidhur me Kosovën qeveria federale gjermane nuk u përball vetëm në *Bundestag*. Zyrtarët e lartë gjermanë gjithashtu shfaqnin dyshime serioze lidhur me nevojën për të dërguar trupat ushtarake në një mjedis konfliktuoz në Evropën Juglindore, pa qëllime ushtarake të përcaktuara qartë dhe mbi të gjitha pa një mandat eksplisit të Këshillit të Sigurimit. Megjithatë treshja qeveritare Schröder-Fischer dhe Scharping argumentoi se zgjidhja e konfliktit të Kosovës ishte në interes të sigurisë

<sup>75</sup> J. Fischer, *Die rot-grünen Jahren ...*, f. 146.

<sup>76</sup> K.Kaser, W.Petritsch, R.Pichler, *Kosovo – Kosova ...*, f. 326-237.

<sup>77</sup> Dario Malnar, *SHBA-ja dhe Kosova*, Prishtinë: Koha, 2013, f. 210.

<sup>78</sup> Michaela Wiegel, “Gegen Amerikas Ein-Mann-Show”, në *Frankfurter Allgemeine Zeitung*, 25.02.1999.

së Gjermanisë dhe të vetë BE-së, për shkak të mundësisë së zgjerimit rajonal të luftës. Mirëpo, të gjitha përpjekjet gjatë kësaj periudhe për ta bërë Beogradin të ndryshonte qëndrim përpara rifillimit të bisedimeve nuk po jepnin rezultat. Në rrethana të tilla, më 14 mars 1999, GK u mbledh në Paris për të vlerësuar përpjekjet diplomatike të periudhës 23 shkurt - 14 mars dhe për të përcaktuar strategjinë për fazën vijuese. Ky forum diplomatik mbylli çdo mundësi për të diskutuar më tej modalitetet e marrëveshjes së ofruar në Rambuje dhe të gjitha përpjekjet u përqendruan vetëm rreth aspektit të zbatimit të marrëveshjes.<sup>79</sup> Ndërkohë, pala shqiptare kishte sinjalizuar se do ta pranonte marrëveshjen, ndërmjetësit ndërkombëtarë ranë dakord që konferenca të ishte e kufizuar në pikëpamje kohore dhe nëse pala serbe do të vazhdonte të refuzonte bisedimet për zbatimin e marrëveshjes, ato do të ndërpriteshin. Ashtu siç ishte paralajmëruar, më 15 mars 1999, filloi në Qendrën Ndërkombëtare të Konferencave në Paris, në avenynë “Kleber”, raundi i dytë i Konferencës ndërkombëtare për Kosovën, me pjesëmarrjen e delegacionit të Kosovës dhe të Serbisë si dhe të ndërmjetësuesve ndërkombëtarë. Në bazë të konkluzioneve të mëparshme, delegacioni i Kosovës menjëherë në ditën e parë të Konferencës dorëzoi një letër zyrtare me të cilën konfirmonte pranimin dhe gatishmërinë për të nënshkruar marrëveshjen e përkohshme, të negociuar në Rambuje.<sup>80</sup> Në këtë letër, kryesuesi i delegacionit, Thaçi, theksoi se marrëveshja nuk ishte një zgjidhje ideale për Kosovën, por delegacioni kishte arritur në përfundimin se për momentin ky ishte varianti më i mundshëm dhe më premtues për zgjidhjen e statusit kalimtar të Kosovës. Në letër, Thaçi shkruante po ashtu se “delegacioni i Kosovës e pranon në tërësi Marrëveshjen për Kosovën dhe është i gatshëm ta nënshkruajë atë.”<sup>81</sup> Edhe në letrën dërguar kryesuesit të Këshillit të BE-së, ministrit të Jashtëm gjerman, Fischer, kryesuesi i delegacionit të Kosovës pohonte pranimin e marrëveshjes dhe priste një mbështetje të BE dhe të Gjermanisë në zbatimin e saj.<sup>82</sup> Në anën tjetër, ministrat e Jashtëm të Francës dhe të

<sup>79</sup> W. Petritsch, K. Kaser, R. Pichler, *Kosovo/Kosova ...*, f.331.

<sup>80</sup> Heike Krieger, *The Kosovo Conflict and International Law: An Analytical Documentation 1974-1999*, Cambridge University Press, Cambridge: 2001, f. 280. Letër e delegacionit të Kosovës drejtuar ministrave të Jashtëm të Francës dhe të Britanisë së Madhe, 15 mars 1999.

<sup>81</sup> S. Ukshini, *Kosova dhe Perëndimi ...*, f. 220-221.

<sup>82</sup> M. Weller, *Contested Statehood ...*, f.150.

Britanisë së Madhe, reagues me tone pozitive, duke thënë se “ky është një lajm shumë i mirë të cilin e përshëndesim” dhe njëkohësisht apelonin te delegacioni serb që të bënte një hap të tillë, në të kundërtën do të ballafaqoheshin me sulmet e Aleancës Veriatlantike.<sup>83</sup>

Megjithatë qëndrimi i palës serbe ishte krejt ndryshe. Që në fillim pala serbe përdori manovrën e rifillimit të gjërave nga e para, e hodhi poshtë gjithçka që ishte negociuar më parë në Rambuje dhe kërkoi rihapjen e diskutimit për marrëveshjen politike në tërësi dhe që e gjitha të nisej prej fillimit.<sup>84</sup> Mirëpo, kryesuesi i konferencës dhe ndërmjetësit ndërkombëtarë e hodhën poshtë këtë propozim të palës serbe dhe me këtë u bë e qartë se bisedimet nuk do të vazhdonin më tej. Të ballafaquar me situatën e re negociatorët ndërkombëtarë, pa praninë e përfaqësuesit rus, më 18 mars 1999 organizuan ceremoninë e nënshkrimit formal të tekstit të marrëveshjes, në formën e datës 23 shkurt. Mirëpo, nënshkrimi i Marrëveshjes së Rambujesë u bë vetëm nga delegacioni i shqiptarëve të Kosovës, derisa delegacioni serb që nuk ishte i pranishëm aty refuzoi nënshkrimin.<sup>85</sup> Milosheviçi ishte inkurajuar nga mbështetja e Rusisë se do të pamundësohej çdo rezolutë për lejimin e dërgimit të trupave ushtarake në Kosovë. Me këtë refuzim, negociatori rus Majorski, më 19 mars 1999, deklaroi se dokumenti i Rambujesë, nënshkruar nga delegacioni i Kosovës, nuk ishte i vlefshëm, pasi përmbante elementë që nuk ishin miratuar nga të gjithë anëtarët e GK. Kështu shkoi dëm përpjekja e gjermanëve për ta mbajtur në bord edhe faktorin rus, i cili edhe një herë doli në mbrojtje të regjimit të Milosheviçit. Në atë situatë, NATO ndodhej para një konfrontimi me një shtet ballkanik të rangut të tretë, i cili ishte përgjegjës për katër luftëra në rajon. Pas përmbylljes shterruese të procesit politik, nëpërmjet të cilit u bë përpjekje të zgjidhej kriza që po zgjerohej në Kosovë, më 24 mars 1999, filluan sulmet ajrore të NATO-s kundër Jugosllavisë së mbetur<sup>86</sup>, si mjet për ta detyruar Milosheviçin t’i jepte fund operacioneve ushtarake dhe policore në Kosovë dhe me këtë të pranonte planin e paqes, por të refuzuar në Rambuje.

<sup>83</sup> S. Ukshini, *Kosova dhe Perëndimi ...*, f.221.

<sup>84</sup> M. Weller, *Contested Statehood ...*, f.151.

<sup>85</sup> S. Ukshini, *Kosova dhe Perëndimi ...*, f.225.

<sup>86</sup> J. Reuter, “Die Kosovo-Politik der internationale ...”, f. 330.

*S u m m a r y*

## THE ROLE OF GERMAN POLICY IN THE RAMBOUILLET PEACE CONFERENCE

The German Federal Government supported uprightly the US position in this conference, but demanded the diplomacy of force to be truly tied to the political initiatives in an international conference. The result of these diplomatic efforts was also the Peace Conference in Rambouillet, in which Albanians of Kosovo and Serbia should find a solution for Kosovo's autonomy in a transitional period.

The role of German Foreign Policy of peace negotiations in Rambouillet from February 6 to February 23, 1999, and from March 15 to March 23, 1999 in Paris was too significant for the efforts of the Contact Group, EU and USA for reaching a political solution to the issue of transitional status of Kosovo. In this context, German diplomacy at this conference set the tone to maintaining cohesion too among partners involved in Rambouillet, which was the last attempt to reach a political deal between the delegation of Kosovo Albanians and the Serbian delegation. Schröder-Fischer Federal Government saw this conference as the last opportunity to avoid the military intervention of NATO.

Being the next EU's presiding leader and also the leader of G-8, Germany made its best efforts to exploit exhaustively all means and possibilities to avoid the military option of NATO against military targets and repressive forces of remained Yugoslavia, even though the Russian authorities have warned to use the right of veto in the UN Security Council as a response toward any military option.

The Federal Government coalition of left right-green coalition, through the Special Representative of the EU for Kosovo, Ambassador Wolfgang Petristch, and its diplomats, tried maximally to move out both sides of their stances that were diametrically opposite. Its role was crucial, although some authors have tried to outline the role of Bonn as peripheral. Once that conference was finally failed on March 18, 1999, Germany participated in the military operation of NATO in the framework of Operation Allied Force, which began in the eve of March 24, 1999. In fact, Germany, since the outbreak of war in Kosovo in the spring of 1998 played an active security policy for long-term stabilization of the region and through diplomatic initiatives gave decisive impulses of its commitment in the field of foreign policy and security of the EU.

